



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

ARSIMI PROFESIONAL III
(ADMINISTRATË, EKONOMI, ADMINISTRIM BIZNESI,
HOTELERI, TURIZËM)



Prishtinë, gusht 2009

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

"Meqenëse pata një armëpushim me armiqtë e mij turq, nuk desha t'ja kursej ndihmën time mikut tim Ferdinando, sepse Alfonsi, i jati i tij, më ka ndihmuar në luftë kundër turkut.

Sa për punë fisnikërie që ti më përmend unë dua të të kujtoj se sot fisnik të bën vetëm një luftë e drejtë dhe e ndershme. Mos harro këtë që po të them, nuk ka fisnikëri më të madhe se trimëria dhe neve nesër do t'ja shohim fisnikërinë njëri tjetrit.

Deri më sot që jam duke luftuar me ushtarët e tu, s'kam parë asnjë trim tëndin që të guxojë të më vështrojë drejt e në sy siç bëj unë me ata!

Unë nuk e kam zili shtëpinë tënde dhe të askujt mbase më mjafton shtëpia ime, por, nëse do të ngelesh gjallë, kërkoj që të mos i prekësh kurrë tokat e mikut tim Ferdinando!

Mbeç me shëndet! Skënderbeu."

1. Fragmenti mbizotërohet nga diskursi:

- A. politik
- B. religjioz
- C. historik
- D. letrar

2. Ironia shprehet në fjalinë:

- A. pata një armëpushim me armiqtë e mij turq
- B. sot fisnik të bën vetëm një luftë e drejtë
- C. nesër do t'ja shohim fisnikërinë njëri tjetrit
- D. unë nuk e kam zili shtëpinë tënde

3. Periudha: "Meqenëse pata një armëpushim me armiqtë e mij turq, nuk desha t'ja kursej ndihmën time mikut tim" shpreh marrëdhënie:

- A. kushtore
- B. shkakore
- C. lejore
- D. kundërshtore

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Askush nuk do të ishte i interesuar të investojë në kapacitete që mund t'i shfrytëzojë vetëm një çerekshekulli. Nëse duhen pesë vjet për ndërtimin e termocentralit, koncesionarit i mbeten 20 vjet që ta shfrytëzojë këtë pasuri. Kur kemi parasysh shkallën e amortizimit të kapaciteteve prodhuese, fitimi do të jetë i barabartë me zero. Për këtë kohë investitori ka mundësi të kthejë edhe tërë kapitalin që e ka futur. Ai nuk humb asgjë. Të këtilla janë edhe përvojat nga vendet që i kanë dhënë pasuritë e tyre në shfrytëzim për afate të caktuara. Duket se për këtë vendim janë marrë për bazë vetëm rezervat e qymyrit.

(Marrë dhe përshtatur nga gazeta *Express*)

4. Nga teksti i dhënë më lart del se investimet e huaja në Kosovë:

- A. Janë atraktive për shkak të afatit të shkurtër të koncesionimit
- B. Janë atraktive për shkak të resurseve të bollshme natyrore
- C. Nuk janë atraktive për shkak të mungesës së resurseve natyrore
- D. Nuk janë atraktive për shkak të afatit të shkurtër të koncesionimit

5. Informata themelore që nxirret nga ky fragment është:

- A. Konkensionimi nuk është mbështetur në përvojat e vendeve të tjera
- B. Afatet kohore për koncesionim janë tepër të shkurtra
- C. Investuesit e huaj dalin me humbje nga periudha e koncesionit
- D. Investuesit dalin me fitime nga periudha e koncesionit

6. Periudha: *“Të këtilla janë edhe përvojat nga vendet e tjera”* në kohën më se të kryer të mënyrës habitore bën:

- A. Të këtilla paskëshin qenë edhe përvojat nga vendet e tjera
- B. Të këtilla paskan qenë edhe përvojat nga vendet e tjera
- C. Të këtilla qenkëshin edhe përvojat nga vendet e tjera
- D. Të këtilla qenkan edhe përvojat nga vendet e tjera

7. Fjalinë: *Në aktet juridike e shkresat zyrtare të zbatohet drejtshkrimi i njësuar dhe norma e gjuhës letrare kombëtare, e bën urdhërore fjala a formanti:*

- A. në
- B. të
- C. zbatohet
- D. zyrtare

Lexo paragrafin e dhënë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

- Të falem motër mos më përqafo! Unë kam një mot që po lëngoju në shtrat. Mezi kam ardhur të të marrë në shtëpi. Eja të shkojmë se të kërkon nëna.

8. Mbështetur mbi këtë pjesë të shkurtër fragmenti, ju mund të identifikoni (kontekstin) rrethanat se fjala është për:

- A. motrën e Mujit
- B. motrën e Avdisë
- C. motrën e Halil Garrisë
- D. motrën e Gjergj Elez Alisë

9. Arsyeja pse vëllai i thotë motrës të mos e përqafojë është se:

- A. e urrente që ishte martuar pa lejen e tij
- B. kishte frikë se mund ta infektonte me sëmundjen
- C. nuk kishte mjaft kohë dhe nxitonte për t’u kthyer
- D. kishte frikë se mos e zbulonte që nuk ishte i gjallë

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Nuk do ta merrja këtë libër tepër seriozisht. Kjo nuk është një përpjekje për të zgjidhur një pe në nyjën ballkanike; nuk është studim për popujt primitivë; nuk është kontribut për dijet njerëzore dhe shpresoj se asnjëri nuk do ta lexojë për ta përmirësuar trurin e vet. Kjo duhet të lexohet ashtu siç janë përjetuar aventurat në të, me një ngarendje të hareshme të mendjes, me një shije për popujt e huaj dhe shtigje të panjohura dhe me një kënaqësi për të papriturën.

Këtu po u jap vetëm atë që kam parë, ndier dhe sidomos që kam mësuar në baritjet në mesin e fiseve në brendi të maleve veriore shqiptare. Madje, kjo nuk është as e tërë Shqipëria, ai vend i vogël, tepër i vogël edhe për ta gjetur edhe në hartë. Ky nuk është pos një fragment i kësaj bote të gjerë, tjetërfare dhe romantike, që ua sjell me vete një shtegtare atyre që rrinë në shtëpi.

R. W. L. (Rouz Uajlder Lein “*Majat e Shalës*”)

10. Cila nga fjalitë e këtij teksti shpreh më së miri zhanrin të cilit i takon ky libër?

- A. shpresoj se asnjëri nuk do ta lexojë për ta përmirësuar trurin e vet
- B. kjo duhet të lexohet me një ngarendje të hareshme të mendjes
- C. kjo duhet të lexohet me një shije për popujt e huaj dhe shtigje të panjohura
- D. këtu po u jap vetëm atë që kam parë, ndier dhe sidomos që kam mësuar

11. Në aspektin kompozicional, fragmenti i shkëputur mund të vendoset:

- A. vetëm në fund të librit
- B. vetëm në fillim të librit
- C. vetëm në mes të librit
- D. qoftë në fillim qoftë në fund

Lexo poezinë e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Le mbas vetes Detin, Malin, Tokën, Fushën,
E shtëpisë së moçme i vë dry në derë
Me litar shpëtimi prapë e lidhe gushën
Frymën zënë që pate e hudhe në erë

I ikur nga dheu nis mërgim të ri
Ta gjesh botën tënde që ik diku larg
Nëpër terr të qiellit që të vesh në zi
Ndjek yjet e shpresës të nisur në varg

Me ngulm e ndjek kohën që ik e ik
Ajo të vjen mbas gjurmëve si breshkë
Duke ngrënë veten në fund gjaku pik
I kuq, jo i zverdhur si gjethi në vjeshtë

Këmba doras koha nuk është ti, është rrenë
Nuk do ta thotë lajmin pos qeshjes së kotë
Tash gjurmët e breshkës i ruan një qen
Në qafë i var ndërrimet që bëhen në botë

.....
(Sabri Hamiti “*Trungu Ilir*”)

12. Në këtë poezi shprehet një ndjesi e rrëfimit lirik për:

- A. largimin
- B. kthimin
- C. zemërimin
- D. përmallimi

13. Vargjet: *Nëpër terr të qiellit që të vesh në zi*
Ndjek yjet e shpresës të nisur në varg,
janë gërshetim i figurës së:

- A. hiperbolës dhe alegorisë
- B. personifikimit dhe krahasimit
- C. metaforës dhe simbolit
- D. antitezës dhe ironisë

14. Kjo poezi është me:

- A. rimë të alternuar dhe varg të matur
- B. rimë të kryqëzuar dhe varg të bardhë
- C. rimë të puthur dhe varg të lirë
- D. rimë të ndërprerë dhe varg të thyer

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

I.

Terri u derdh, e një rrigë e praruar e rrezëve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohet. Çdo gjë është struktur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit.

E lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton duke lënë mbas vetes një hark të gjatë vezullues.

II

Një klithmë u dëgjua.

Korbi krokati.

E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë.

Lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan. Edhe qyqja kukati tri herë. As bulku nuk mbeti pa lëshuar zë.

Kurse hëna ndali rigën e praruar të rrezeve të veta. Ajo u fsheh mbas një reje me skaje të grisura. Nuk desh të shihte krimin, nuk desh të përlyhej nga pikat e gjakut që i lëshonte prerja e korbit.

Një hije, si hije vdekjeje, kaploi vendin.

(Anton Pashku "Klithma")

15. Cila nga strukturat e fjalisë nis thyerjen e atmosferës në këtë rrëfim?

- A. edhe qyqja hesht
- B. një klithmë u dëgjua
- C. qyqja kukati tri herë
- D. as bulku nuk dëgjohet

16. Përmasa e prishjes së qetësisë shprehet më së miri me fjalinë:

- A. terri u derdh, e një rrigë e praruar e rrezëve të hënës e lau kreshtën e malit
- B. çdo gjë është struktur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit
- C. e lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton
- D. lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

...Kush mundetë me i raam mboh se ma i vobek kje Vuça Pasha, i silli, për të mbledhë një ushtërij 12 mijë vetësh, nuk' imbastuenë shumë milionj aarm, se Kelmandasitë tanë, të sijtë, me një zaan' – Eja kush anshtë trim – mbëledhunë afërë 500 vetë, vraanë, Vuçe Pashënë, vjetit së Krishtit 1639, e ndë nevojë mpsuen me granë lëkurën' e qarrit, posi të begatët majën' e miellit ende atyne ajo gjellë ma shije u ka, se pashallarëvet e sanxhakëvet mishi i kingjave e vjetëvat njomë....

(Pjetër Bogdani “*Burrëniya e malësorëve*”)

17. Gjuha e këtij fragmenti i takon:

- A. gegërishtes së shek. XVI
- B. toskërishtes së shek. XVI
- C. gegërishtes së shek. XVII
- D. toskërishtes së shek. XVII

18. Nëse fjalia: “*Kush mundet me i raam mboh se Kelmandasitë tanë, me një zaan mbëledhunë afërë 500 vetë.*”, kthehet në shqipen e sotme standarde, bën:

- A. Kush mund ta mohojë se kelmendasit tanë me një zë mblodhën 500 veta.
- B. Kush mund ta mohojë se kelmendasit tanë me një za mblodhën 500 veta.
- C. Kush mund ta mohon se kelmendasit tanë me një zë mblodhën 500 veta.
- D. Kush mund ta mohon se kelmendasit tanë me një za mblodhën 500 veta.

19. Neologjizmat janë karakteristikë tipike për poezinë e:

- A. Bejtexhinjve
- B. Rilindjes
- C. Realizmit
- D. Modernitetit

Lexo paragrafin e dhënë dhe përgjigju pyetjes

Ai është i ri, kryetrim, i vrullshëm dhe në zemërim i papërmbajtur, që ka përdhosur kufomën e armikut të vvarë, Hektorit, duke e tërhequr përreth mureve të Trojës pa çarë kokën për lutjet e një plaku të pafuqishëm - Priamit.

20. Për cilin nga heronjtë e veprave të Homerit bëhet fjalë?

- A. Hektori
- B. Agamemnoni
- C. Odiseu
- D. Akili

ENGLISH LANGUAGE

21. Choose the correct alternative to complete the following sentence:


Kosova declared its independence on 17/02/2008.

The Independence of Kosova was declared on _____.

- A. the seventeenth of February, two thousand and eight
- B. the seventeenth of two thousand and eight, February
- C. the February of seventeenth, two thousand and eight
- D. the seventeenth February of two thousand and eight

22. This graph shows the business scale of a company during five years period. Look at the chart below and choose the correct sentence:

- A. In the year 2001 sales rose slightly.
- B. In 2002 sales rose rapidly.
- C. In 2003 there was a steady fall of sales.
- D. In the five year period the sales rose steadily.



23. Read the following sentences:

- 1. Oh, he's a very good friend of mine.
- 2. I can't believe this. How come you never mentioned him?
- 3. You've never asked me, have you?
- 4. Where have you been all day? The boss was asking for you.
- 5. I had lunch with a very interesting man, Tom Henson.

The correct order of sentences to form a dialogue is:

- A. 3 2 1 5 4
- B. 1 2 3 4 5
- C. 4 5 1 2 3
- D. 5 4 3 1 2

24. ONLY ONE of the words below CANNOT be used to complete the following sentence. Which one?

My friends constantly speak well of our professors. They say they are very much _____ to their professors for everything they did for them for all these years.

- A. obliged
- B. indebted
- C. thankful
- D. infuriated

25. Read this text and then choose a sentence to complete the paragraph:

I am planning to continue my studies. I always wanted to study in England. Last month, I applied and I took an English language test but I was just two points short to pass it. That's why _____.

- A. I started learning English again
- B. I am very happy
- C. I am very surprised
- D. I am planning to quit

26. In the following dialogue:

Barbara: I have always imagined him _____.

Peter: Me too, but he seems quite a nice guy.

from the following words:

1. differently
2. likely
3. hopefully
4. unlikely

Barbara should say, **'differently'** because _____.

- A. it is probable that he should look similar
- B. it is expected that he should be similar
- C. the reality does not fit the image she had in her mind
- D. it is improbable that he doesn't look as she expected

27. Choose the correct answer to complete the sentence:

This is the _____ drink I have ever drunk.

- A. sweetest
- B. sweeter
- C. more sweet
- D. most sweet

28. The sentence: **'Everybody wants to be rich and famous.'** is in the _____.

- A. Present continuous tense
- B. Present simple tense
- C. Past simple tense
- D. Future continuous tense

29. Look at the following adjectives. One of them **DOES NOT** exist. Which one?

- A. careful
- B. fruitful
- C. rightful
- D. funniful

30. Choose the best way to join the following sentences:

We arrived very late that day.

The teacher told us to wait until the next class.

- A. We arrived very late that day so the teacher told us to wait outside.
- B. We arrived very late that day since the teacher told us to wait outside.
- C. We arrived very late that day but the teacher told us to wait outside.
- D. We arrived very late that day or the teacher told us to wait outside.

31. Choose the correct sentence:

- A. In France as parts of Italy they speak French as well.
- B. They in France speak French as well as parts of Italy.
- C. They speak French in France as well as parts of Italy.
- D. They French speak in Italy as well as parts of France.

32. Look at the words in the box:

away - several – got – money – robbers – bags – the – with - of

The correct combination to form a sentence is:

- A. The robbers got with several away bags of money.
- B. The robbers got away with several bags of money.
- C. The robbers with bags got away several of money.
- D. The robbers with several bags got away of money.

33. Which word is different?

- A. blue
- B. quick
- C. hard
- D. slow

34. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

We always _____ the flowers in the evening.

The world faces the _____ crisis.

- A. watch
- B. drink
- C. care
- D. water

35. One of the words below DOES NOT rhyme with the word meat? Which one?

- A. mean
- B. seen
- C. slim
- D. feast

36. In the string of words: books, shelves, magazines, novels, anthologies, the word shelves is different because _____.

- A. it is a noun
- B. it is in plural
- C. it can be read
- D. it can't be read

37. Read the paragraph carefully:

Angela Bond is a student. **I suppose she is a first year student. She studies French and Spanish at Oxford University.** She's wearing a white skirt – its quite long – with a green blouse, and white shoes. She's around average height, and she's got brown hair and dark brown eyes.

Look at the highlighted part of the text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. is sure she's a first year student
- B. isn't sure if she is in her first year of studies
- C. doesn't tell in which year of studies she is
- D. is quite convinced that she is not a student


38. The following sign means that _____

- A. this is where you can get information you are interested in
- B. this is where you have to answer all the questions
- C. this is where people can ask you all questions
- D. this is where people are interviewed



39. This sport is very popular in the English speaking world and especially in America. It is known as:

- A. cricket
- B. polo
- C. baseball
- D. soccer



40. Read the following paragraph:

Two airplanes are taking off at the same time from Berlin Airport: a Boeing 747 with 452 passengers and the crew of 3 and an Airbus A310 carrying 220 passengers and 3 crew members. They are flying to London. The total number of people on board of the two planes is _____.

- A. 667
- B. 678
- C. 687
- D. 676


MATEMATIKË

41. Pas thjeshtimit shprehja $A = \frac{x^2 - 5x}{x+1} \cdot \frac{x^2 - 1}{x-5}$ ka formën :

- A. $A = x(x-1)$
- B. $A = \frac{2}{x-1}$
- C. $A = \frac{2}{x+1}$
- D. $A = x(x+1)$


42. Është dhënë diagrami. Cila shprehje i përgjigjet pjesës së hijesuar në diagram ?

- A. $A \setminus (B \cup C)$
- B. $A \cup (B \setminus C)$
- C. $A \cup (C \setminus B)$
- D. $(A \cup C) \setminus B$




43. Është dhënë figurat. Cila shprehje paraqet shumën $\vec{AB} + \vec{BC}$?

- A. $\vec{AB} + \vec{BC} = \vec{DB}$
- B. $\vec{AB} + \vec{BC} = \vec{DC}$
- C. $\vec{AB} + \vec{BC} = \vec{AD}$
- D. $\vec{AB} + \vec{BC} = \vec{AC}$



44. Është dhënë figura. Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e figurës?

- A. $a \cdot b$
- B. $a \cdot b - x^2$
- C. $a \cdot b + x^2$
- D. $a + b + x^2 + 2x$




45. Cilat janë zgjidhjet e ekuacionit: $\frac{2x+1}{x} - x = 2$?

- A. $x_1 = -\frac{1}{2}, x_2 = \frac{1}{2}$
- B. $x_1 = -\frac{1}{3}, x_2 = \frac{3}{3}$
- C. $x_1 = -1, x_2 = 1$
- D. $x_1 = -2, x_2 = 2$

46. Është dhënë trapezi kënddrejtë ABCD me kënde të drejta te kulmi A dhe D dhe me brinjë $[AB] = 4 \text{ cm}$, $[AD] = 4 \text{ cm}$ dhe $[DC] = 1 \text{ cm}$. Sa është perimetri i trapezit?

- A. $P = 12 \text{ cm}$
- B. $P = 14 \text{ cm}$
- C. $P = 16 \text{ cm}$
- D. $P = 18 \text{ cm}$



47. Është dhënë funksionit $f(x) = \frac{1}{2}(x^2 - 1)$. Sa është vlera: $3 \cdot f(-1) + 4 \cdot f(0)$?

- A. 1
- B. 2
- C. -1
- D. -2


48. Është dhënë brinja e kubit $a = (x + 1) \text{ cm}$. Në qoftë se brinja e kubit zvogëlohet për 1 cm , atëherë sa është syprina e kubit ?

- A. $S = x^2 \text{ cm}^2$
- B. $S = (x - 1)^2 \text{ cm}^2$
- C. $S = 6x^2 \text{ cm}^2$
- D. $S = 6(x - 1)^2 \text{ cm}^2$

49. Në rrethin e dhënë $[\vec{OA}]$ paraqet rrezevektori i fillimit të këndit $x = \frac{11\pi}{4}$ ku $\pi = 180^\circ$.

Në cilin kuadrant ndodhet rrezevektori i mbarit të këndit x ?

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV



50. Janë dhënë gjykimet:

$$p: \frac{1 + \frac{1}{4}}{2 - \frac{1}{3}} = \frac{3}{4};$$

$$q: \frac{2}{3} + \frac{5}{4} = \frac{8+15}{7} = \frac{13}{7};$$

$$r: \left. \begin{array}{l} \text{Zgjidhja e sistemi të ekuacionit: } \\ x^2 - y^2 = 3 \\ 2x - y = 2 \end{array} \right\} \text{ është } x = 2, y = -1.$$

Cili nga pohimet është i saktë:

- A. Vetëm gjykimi p është i saktë.
- B. Vetëm gjykimi q është i saktë.
- C. Vetëm gjykimi r është i saktë.
- D. Të tre gjykimet janë të saktë.

51. Me cilën shprehje është e barabartë shprehja $\frac{3x^6 y^5 z^3}{2xz^8} \cdot 8x^2 y^4 z^3$?

- A. $\frac{12x^7 y^3}{z^2}$
- B. $\frac{12x^5 y^9}{z^2}$
- C. $12x^7 y^9 z^{-2}$
- D. $12x^7 y^9 z^2$

52. Sa është vlera e x ashtu që mesi aritmetik i numrave: 3, 7, 13, x , 5 të jetë i barabartë me 8 ?

- A. 6
- B. 8
- C. 10
- D. 12

53. Është dhënë numri kompleks $z = (2+i)^2$, (ku $i = \sqrt{-1}$). Vlera reale imagjinare $\text{Im}(z)$ është:

- A. $\text{Im}(z) = 3$
- B. $\text{Im}(z) = 4$
- C. $\text{Im}(z) = -3$
- D. $\text{Im}(z) = -4$

54. Cili barazim paraqet probabilitetin e kundërt të ngjarjes A ?

- A. $P(\bar{A}) = \Phi$
- B. $P(\bar{A}) = 1 + P(A)$
- C. $P(\bar{A}) = 1 - P(A)$
- D. $P(\bar{A}) = 1 - P(\bar{A})$

55. Është dhënë barazimi $\frac{4 \cdot 9}{16} = 2^a \cdot 3^b$. Sa është shuma $a + b$?

- A. 0
- B. 2
- C. 4
- D. 6

56. Sa korda mund të caktohen me 7 pika në një vije rrethore?

- A. 14
- B. 15
- C. 20
- D. 21

57. Cili nga thyesat e mëposhtme ka vlerë më të madhe për çdo x numër pozitiv ?

- A. $\frac{x-1}{x}$
- B. $\frac{x+2}{x+1}$
- C. $\frac{x-1}{x+1}$
- D. $\frac{x}{x+1}$

58. Një shitëse lulësh në një panair që zgjati 7 ditë shiti: në ditën e parë 6 lule në ditën e dytë 10 në ditën e tretë 15 në ditën e katër 21 lule dhe kështu me radhë. Sa lule ajo shiti në ditën e fundit nëse vazhdimisht rritej shitja sipas rregullës së fituar ?

- A. 40
- B. 43
- C. 45
- D. 47

59. Cili jobarazim është i saktë për vlerën e $\cos 100^\circ$?

- A. $-\frac{1}{2} < \cos 100^\circ < 0$
- B. $-1 < \cos 100^\circ < -\frac{1}{2}$
- C. $0 < \cos 100^\circ < \frac{1}{2}$
- D. $\frac{1}{2} < \cos 100^\circ < 1$

60. Ndryshimi i dy numrave është 5, ndërsa prodhimi i tyre është 104. Cilët janë ata numra?

- A. 6 dhe 11
- B. 7 dhe 12
- C. 8 dhe 13
- D. 9 dhe 14

INFORMATIKË

61. Opsioni i zgjedhur në figurë mundëson:

- A. Mbylljen e animacionit
- B. Përgatitjen e animacionit
- C. Përgatitjen e nën animacionit
- D. Shikimin paraprak të animacionit

62. Frekuenca e taktit të një mikroprocesori (njësia qendrore e përpunimit të të dhënave-CPU), vlerësohet me njësinë:

- A. Shumëfishe të njësisë Hz (MHz, GHz)
- B. Shumëfishe të njësisë Bajt (KB, MB, GB)
- C. Shumëfishe të njësisë Bit (Kb, Mb, Gb)
- D. MIPS



63. Dëshironi të përdorni postën elektronike gjatë një udhëtimi të gjatë. Cila nga alternativat në vijim mund të lehtësoj pranimin dhe dërgimin e e-mailave gjatë udhëtimit?

- A. Website personal në Internet
- B. Një e-mail llogari e bazuar në Web
- C. Anëtarësimi në një grup diskutues në Internet
- D. Një llogari e shfrytëzuesit të 'chat' faqeve

64. Rrjeti Ethernet pa tela, i cili mundëson lidhjen e kompjuterëve mobil, telefonave mobil dhe pajisjeve tjera të dorës, quhet:

- A. MAN (Metropolitan Area Network)
- B. LAN (Local Area Network)
- C. PAN (Personal Area Network)
- D. WAN (Wide Area Network)

65. Cila pjesë e Web adresës tregon domenin kryesor të Web faqes së paraqitur?

- A. http://
- B. net
- C. www
- D. enlight

66. Në bazë të të dhënave në figure, çfarë vlere do të fitohet në celulën F11?

- A. 300.00
- B. 54.00
- C. 21.50
- D. 74.00

	A	B	C	D	E	F	G
1			Tabela e shpenzimeve Mujore				
2							
3			Shpenzimi			Vlera	
4			Qiraja			300.00 €	
5			Telefoni fiks			42.00 €	
6			Telefoni mobil			54.00 €	
7			Pagesa per uje			6.20 €	
8			Pagesa per rryme			21.50 €	
9			Tjera			74.00 €	
10							
11						=MAX(F5;F9)	
12							

67. Hiperlidhja mund të krijohet për të ndërlidhur dy dokumente në:

- A. Kompjuter, rrjet, Intranet të korporatës ose në Internet
- B. Në një Gjuhë programuese
- C. Në një Firewall
- D. Në një tabelë

68. Opsioni **Tasks** në programin **MS Outlook**, ka të bëjë me:

- A. Krijimin e notesit elektronik,
- B. Detyrimet të cilat duhet të kryhen
- C. E-mai mesazhet që pranohen,
- D. Ruajtjen e adresave të kontaktit

69. Ndryshimin e të dhënave në programin **MS Excel** e mundëson tasti:

- A. Alt
- B. Insert
- C. F2
- D. F5

70. Objektet: **Tables, Queries, Forms, Reports, Pages, Macros, etj.** , i takojnë programit:

- A. MS Word
- B. MS Excel
- C. MS Access
- D. MS PowerPoint

EDUKATË QYTETARE

71. Çfarë kanë të përbashkët vandalizmi dhe vrasja?

- A. Janë forma të krimit
- B. Janë forma të qeverisjes shtetërore
- C. Janë forma të komunikimit publik
- D. Janë forma të fesë

72. Pushteti i Qeverisjes Shtetërore arrihet përmes tri degëve: legislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Dega ekzekutive ka pushtetin:

- A. të nxjerr ligjet e vendit
- B. të zbatojë dhe përforcojë ligjet e nxjerra
- C. të zgjidh mosmarrëveshjet dhe konfliktet mbi bazën e ligjit
- D. të ndryshojë ligjet ekzistuese

73. Organizime të votuesve që dëshirojnë të ndikojnë dhe kontrollojnë vendimmarrjet e qeverisë, duke rekrutuar anëtarë për poste publike quhen:

- A. grupe të interesit
- B. ndërmarrje publike
- C. parti politike
- D. komunitete

74. Mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e:

- A. qeverisjes vendore (lokale)
- B. qeverisjes qendrore
- C. partive politike
- D. komunitetit

75. Nëse personit i është mohuar e drejta për mundësi të barabartë për shkak të përkatësisë fetare, kemi të bëjmë me:

- A. krim
- B. solidaritet
- C. stereotip
- D. diskriminim

76. Zëvendësoni vendin bosh me një term adekuat të shënuar me poshtë, që fjalisë së dhënë t'i jep kuptim:

_____ janë individë që migrojnë nga vendi i tyre për shkak të problemeve ekonomiko-sociale drejt vendeve më ta pasura.

- A. Refugjatët
- B. Emigrantët
- C. Të përndjekurit politik
- D. Të papunët

77. Cilën të drejtë përdor personi që e kritikon qeverinë dhe zyrtarët e saj?

- A. Të drejtën e fjalës së lirë
- B. Të drejtën e mendimit të lirë
- C. Të drejtën e kritikës së pakufi në demokraci
- D. Të drejtën e fyerjes së qeverisë së keqe

78. Edukimi ndërkulturor nënkupton:

- A. shkallën e koekzistencës e të bashkëveprimit të kulturave të ndryshme ose relativisht të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e arsimimit të një vendi
- B. shkallën e koekzistencës e të bashkëveprimit të kulturave të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të komunitetit të njëjtë, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e varfërisë së një vendi
- C. shkallën e koekzistencës e të bashkëveprimit të kulturave të ndryshme ose relativisht të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e demokratizimit të një vendi
- D. shkallën e koekzistencës e të bashkëveprimit të kulturave të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të komunitetit të njëjtë, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e krimit të një vendi

79. Lexo me kujdes pohimet në vijim:

- I. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përbehet nga 15 anëtarë dhe është përgjegjës për paqen dhe sigurimin ndërkombëtar.
- II. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përbehet nga 15 anëtarë dhe është përgjegjës për çështjet ndërkombëtare të ekonomisë.
- III. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përbehet nga 15 anëtarë dhe është përgjegjës për mbrojtjen e pasurisë kulturore .

Cili nga pohimet është e saktë për Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara?

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. I dhe II
- D. II dhe III

80. Çfarë trajton ligji civil?

- A. Raportet e personave me shoqërinë dhe shtetin
- B. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve
- C. Marrëdhëniet e individëve me njerëz të tjerë dhe grupe njerëzish
- D. Përcaktimin e parimeve themelore të organizimit praktik të shoqërisë dhe shtetit

81. Gjykata komunale është:

- A. gjykatë supreme, dënimi më i lartë i së cilës është deri 5 vjet heqje lirie
- B. gjykatë për kundërvajtje, dënimi më i lartë i së cilës është deri 3 vjet heqje lirie
- C. gjykatë themelore, dënimi më i lartë i së cilës është deri 5 vjet heqje lirie
- D. gjykatë ushtarake, dënimi më i lartë së cilës është deri 10 vjet heqje lirie

82. Si zgjidhet presidenti në sistemin presidencial?

- A. nga vota e drejtpërsëdrejti e votuesve
- B. nga parlamenti me shumicë votash
- C. nga kryetari i qeverisë
- D. nga mbreti ose mbretëresha

83. Cili është qëllimi i Këshillit të Sigurimit?

- A. Qeverisja e shteteve në konflikt
- B. Ruajtja e paqes dhe sigurinë ndërkombëtare
- C. Siguria e personave të kërcënuar
- D. Vendosija e ligjeve themelore botërore

84. Cili është qëllimi parësor i NATO-s?


- A. Ndërhyrja e menjëhershme në rast të kërcënimit luftarak të ndonjë shteti në shtetin tjetër
- B. Ruajtja e pavarësisë dhe e kufijve të shteteve sovrane dhe demokratike
- C. Ndërhyrja në konflikte politike e ushtarake të vendeve të Ballkanit dhe të Evropës Qendrore
- D. Ruajtja e lirisë dhe e krijimit të sigurisë të të gjithë anëtarëve të saj me mjete politike dhe ushtarake

85. Informimi zyrtar qëndron aty ku:

- A. qeveria dhe shteti kanë të drejtë të kërkojnë nga qytetarët për t'ua dhënë informatat lidhur më këdo në shoqëri me aq sa personi i pyetur di gjë
- B. shteti ka Ministrinë për Informim dhe ku Ministri rregullisht jep informata për vendimet që janë marrë në qeveri, madje ku për arsye shtetërore edhe mund të japë informata mashtruese pa ndërhyrje nga qytetarët
- C. qytetarët kanë të drejtë ligjore për t'u informuar për arsyetimet dhe vendimet e marra nga organet publike dhe të ndikojnë mbi ta
- D. shteti ka një televizion zyrtar dhe mjetet tjera të informimit për të informuar zyrtarisht lidhur me vendimet e veta dhe këto i kontrollon dhe censuron tërësisht

- 86.** Me çfarë inflacioni kemi të bëjmë nëse çmimet mesatare rriten me norma treshifrore, katërshifrore brenda muajit?
- Latent
 - Hiperinflacion
 - Të përmbajtur
 - Galopant
- 87.** Kush e tregon sasinë e përgjithshëm të të mirave dhe shërbimeve të cilën prodhuesit janë të gatshëm dhe në gjendje ta ofrojnë në treg në një periudhë të caktuar kohore, me nivele të ndryshme të çmimeve?
- Kërkesa
 - Oferta
 - Oferta agregate
 - Kërkesa agregate
- 88.** Çmimet në konkurrencën e përsosur (plotë) përcaktohen nga:
- forcat e tregut
 - ana e shtetit
 - firma monopol
 - dilerët
- 89.** Ekonomia si disiplinë shkencore ka lindur për shkak të:
- mjaftueshmërisë së burimeve
 - pamjaftueshmërisë së burimeve
 - nevojës për të matur atë çka prodhohet
 - përcaktimit të çmimeve në nivel botëror
- 90.** Çfarë relacioni tregon kurba e ofertës?
- Relacionin ndërmjet kapitalit dhe sasisë së ofruar
 - Relacionin ndërmjet sasisë së ofruar dhe faktorëve të prodhimit
 - Relacionin ndërmjet çmimeve dhe sasisë së kërkuar
 - Relacionin ndërmjet çmimeve dhe sasisë së ofruar
- 91.** Cilat janë qëllimet e politikës fiskale në kuadër të ekonomisë nacionale?
- Të sigurojë ne rritje të qendrueshme të taksave, të punësimit dhe të inflacionit
 - Të menjanojë ngritjet dhe rënjet e shpeshta të cikleve të biznesit, të sigurojë një punësim të lartë dhe norma të ulta të inflacionit
 - Të sigurojë një ulje të normave tatimore, efikasitet të tregut dhe lëvizje të shpejta në ekonomi (recensionet dhe ekspansionet)
 - Të menjanojë ngritjet dhe rënjet e shpeshta të cikleve të biznesit, ulje të vazhdueshme të tatimeve, papunësi të lartë.
- 92.** Ku shprehen kostot sociale të papunësisë?
- Në rritjen e GDP – së
 - Në rritjen e konsumit
 - Në zhvlerësimin e kapitalit human dhe rritjen e kriminalitetit
 - Në zhvlerësimin e pajisjeve dhe mallrave të ndryshme

93. Me çfarë strukture të organizimit të menaxhmentit kemi të bëjmë në këtë grafik:



- A. Organizim divisional të departamenteve
- B. Organizim tekniko-teknologjik të departamenteve
- C. Organizim të thjesht të departamenteve
- D. Organizim funksional të departamenteve

94. Në rast të shkëputjës së kontratës së punës sipas ligjit themelor të punës në Kosovë pundhënësi duhet ta paralajmëroj punëtorin:

- A. më së paku 3 muaj përpara
- B. 5 ditë përpara
- C. 1 muaj përpara
- D. nuk është i obliguar ta paralajmëroj

95. Çka përfshihet në përpilimin – hartimin e bilancit të suksesit?

- A. Pasuria dhe detyrimet e ndërmarrjës
- B. Kapitali dhe të hyrat e ndërmarrjës
- C. Shpenzimet e shtyera dhe detyrimet e ndërmarrjes
- D. Të hyrat dhe shpenzimet e ndërmarrjes

96. Cilët janë faktorët të cilët ndikojnë në përcaktimin e lokacionit të ndërmarrjes në kuptimin e ngushtë:

- A. Faktorët mbrojtjës dhe strategjisë së zhvillimit të ndërmarrjës
- B. Faktorët e zhvillimit teknik dhe organizativ të ndërmarrjes
- C. Faktorët ekonomik dhe jo ekonomik të ndërmarrjes
- D. Faktorët objektiv dhe mbrojtës (stabilitetit politik)

97. Ndërmarrjet publike në Kosovë i qeverisin apo administrojnë:

- A. kolektivët punonjëse dhe organet përfaqësuese të tyre
- B. organizatat politike dhe joqeveritare
- C. organet e qendrore dhe lokale të shtetit
- D. organizatat ekonomike dhe asociacionet e tjera ekonomike

98. Me ekonomi liberale kuptojmë sistemin ekonomik të një vendi ku mjetet e prodhimit, shpërndarja e tyre si dhe përcaktimi i çmimeve bëhet nga:

- A. nga forcat e tregut (kerkesa dhe oferta)
- B. nga ndërmjetësuesit financiar në treg
- C. nga një organizëm qendrorë planifikues (shteti)
- D. nga konkurentet të cilët janë të pranishëm në treg

99. Nëse shteti është në deficit buxhetor, dhe ky deficit nuk mund të mbulohet me të hyra të rregullta, atëherë njëra nga metodat të cilat shteti përdor për të mbuluar këtë deficit është:

- A. zvogëlimi i doganave dhe rritja e akcizave
- B. emitimi i parave të gatshme
- C. dhënja e kredive shteteve të jashtme
- D. zvogëlimi i tatimveve dhe rritja e taksave

100. Llogaria kapitale e bilancit të pagesave përfshinë:

- A. shitjen dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve ndërmjet dy apo më shumë vendeve
- B. eksportin dhe importin e mallrave dhe letrave me vlerë ndërmjet dy apo më shumë vendeve
- C. shitjen dhe blerjen e pasurive kapitale ndërmjet dy apo më shumë vendeve
- D. eksportin dhe importin lëndëve të para ndërmjet dy apo më shumë vendeve